



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr.1891/1Prot

Tiranë, më 02.12.2022

**VENDIM**

**Nr.57, datë 02.12.2022**

**PËR**

**REFUZIMIN E RISHIKIMIT TË AKTEVE ADMINISTRATIVE**

Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, neneve 144 - 146 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

**V Ë R E N:**

Në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), pasi ka shqyrtuar ankesat nr. 1755 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1756 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1757 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1758 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1759 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1760 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1761 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1762 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1763 Prot., datë 13.10.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, të depozituara nga Qendra “ALTERUM”, respektivisht, kundër Shoqërisë DIAMOND SOCIETY sh.p.k., Shoqërisë REMI TRANS sh.p.k., Shoqërisë TIRANA BUS sh.p.k., Shoqërisë ALBA TRANS sh.p.k., Shoqërisë TIRANA TRAVEL sh.p.k., Shoqërisë TIRANA URBAN TRANS sh.p.k., Shoqërisë TIRANA LINES sh.p.k., Shoqërisë SHEGA- TRANS sh.a., Shoqërisë MAG UTILITIES sh.p.k., ka marrë Vendimin nr. 31, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 32, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 33, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 34, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 35, datë 25.10.2022, Vendimin nr. 36, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 37, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 38, datë 25.10.2022 dhe Vendimin nr. 39, datë 25.10.2022.

Si rezultat i shqyrtimit të ankesave është konstatuar se shoqëritë e sipërcituara për të cilat është bërë ankimi, nuk janë Autoritete Publike në kuptim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”), ndaj dhe nuk i nënshtrohen dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e tyre.

Për këtë arsye, Komisioneri, në bazë të kompetencave që i njeh ligji ka vendosur: Rrëzimin e ankesave nr. 1755 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1756 Prot., datë 13.10.2022; nr.1757 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1758 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1759 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1760 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1761 Prot., datë 13.10.2022; nr. 1762 Prot., datë 13.10.2022 dhe nr. 1763 Prot., datë 13.10.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, të depozituar nga Qendra “ALTERUM”.

Kundër vendimeve të Komisionerit, nr. 31, datë 25.10.2022; nr. 32, datë 25.10.2022; nr.33, datë 25.10.2022; nr. 34, datë 25.10.2022; nr. 35, datë 25.10.2022; nr. 36, datë 25.10.2022; nr. 37, datë 25.10.2022; nr. 38, datë 25.10.2022; nr. 39, datë 25.10.2022, Qendra “ALTERUM” në cilësinë e kërkuarit, me shkresën nr. 1891 Prot., datë 01.11.2022, ka paraqitur kërkesë me objekt “Revokimin/shfuqizimin e vendimeve të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në kërkesën e sipërcituar Qendra “ALTERUM”, ndër të tjera argumenton se: “Hetimi dhe vlerësimi i ankesave nga ana e Komisionerit nuk është i plotë dhe në përputhje me ligjin. Në verifikimin e tij, Komisioneri nuk ka bërë një hetim të plotë për të verifikuar nëse shoqëritë e kontraktuara nga Bashkia Tiranë për shërbimin e transportit publik janë ose jo shoqëri që kryejnë shërbime publike sipas LDI.

*LDI parashikon dy raste kur një shoqëri tregtare përbën autoritet publik:*

- Shteti zotëron shumicën e aksioneve;
- Ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” (shkronja c parashikon: “çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike)

Në vendimet e tij Komisioneri ka bërë verifikimin vetëm për rastin e parë, kur shteti zotëron shumicën e aksioneve, por nuk ka bërë verifikimin nëse këta subjekte ushtrojnë ose jo funksion publik pavarësisht ndarjes së kuotave. Sipas LDI, neni 2 pika 1, “Autoritet publik” konsiderohet edhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Në rastin konkret, Komisioneri nuk ka bërë hetim të plotë për të vlerësuar nëse subjektet ndaj të cilave është kërkuar informacion, ushtrojnë ose jo funksion publik, në mënyrë që të përcaktohet më pas nëse përbëjnë “autoritet publik” dhe si të tillë janë subjekte të LDI.

Shoqëritë tregtare ndaj të cilave është kërkuar informacion ushtrojnë funksion publik, funksion i cili i ka kaluar nëpërmjet kontratës së lidhur me Bashkinë Tiranë. Sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 23 “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”; në pikën 6 parashikohet se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: “... 6. Transportin publik vendor”, pra shërbimi i transportit publik është funksion publik i bashkisë.

*Këtë funksion të saj bashkia i'a ka kaluar nëpërmjet kontratave të shërbimit kompanive private.*

*Pra, kemi të bëjmë me persona juridik të cilëve u është kaluar e drejta e ushtrimit të funksionit publik, rrjedhimisht kemi të bëjmë me autoritet publik sipas nenit 2 pika 1/c të LDI (vetëm për pjesën e ushtrimit të transportit publik, dhe jo në veprimtari të tjera që mund të kryejnë këto shoqëri).*

*Në praktikën e tij, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka konsideruar si autoritet publik, subjektin "ILLYRIAN GUARD" sh.a, shoqëri aksionere me kapital 100% private, përsa kohë ushtron funksion publik.*

*Gjithashtu në vendimin nr. 41, datë 05.10.2020 Komisioneri ka arsyetuar ndër të tjera: "Fondi Shqiptar i Zhvillimit edhe pse gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse, pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike, është person juridik, i cili ushtron funksione publike dhe nuk përjashtohet si subjekt i LDI".*

*Sa më sipër, kemi një praktikë të konsoliduar nga ana e Komisionerit, i cili ka vlerësuar si autoritet publik edhe një subjekt privat me kapital 100% privat (shoqëri, organizatë), të cilët përbëjnë autoritet publik përsa kohë ushtrajnë funksione publike. Për rrjedhojë, edhe shoqëritë (operatorët ekonomikë) të cilët ushtrajnë funksion publik, atë të transportit publik, funksion ky i kaluar nga Bashkia Tiranë me kontratë shërbimi, përbëjnë autoritet publik sipas LDI dhe si të tillë kanë detyrimin për të dhënë informacion në lidhje me këtë shërbim.*

*Gjithashtu, në nenin 16 të kontratës tip, kontratë shërbimi për "Transportin e udhëtarëve në linjën qytetëse" lidhur ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe Bashkisë Tiranë (që na është vënë në dispozicion në rrugë zyrtare nga Bashkia; shiko përgjigjen bashkangjitur) parashikohet se: "Operatori i linjës, me nënshkrimin e kësaj kontrate, është i detyruar të shqyrtojë ankesat - kërkesat e publikut lidhur me shërbimin, si dhe të informojë publikun mbi shërbimin në linjë, në zbatim të akteve të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore".*

*Sipas kësaj kontrate, qëllimi i saj është "sigurimi i shërbimit qytetës të udhëtarëve brenda juridiksionit territorial të Bashkisë Tiranë nga ana e Operatorit për linjën: "duke garantuar korrektësi, paanësi dhe transparencë gjatë kryerjes së shërbimit dhe kushte optimale shërbimi për udhëtarët" (neni 1 i kontratës tip).*

*Operatorët ekonomikë gjatë ushtrimit të shërbimit ndër të tjera duhet të jenë transparentë sa i takon informacionit për udhëtarët, detyrim ky që përveç parashikimit dhe interpretimit të kontratës në tërësi parashikohet dhe si rast penalizimi në nenin 26 të kontratës tip. Neni 26 i kontratës tip parashikon "b. për mangësi në dhënien e informacionit për klientët/udhëtarët, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe akteve të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore, merret masë me penalizim deri në shumën 30 000 lekë, për çdo rast".*

Komisioneri, pas shqyrtimit të kërkesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, konstaton se kërkuesi nuk ka paraqitur prova të reja për çështjen, në kundërshtim kjo me pikën 2 të nenit 144 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë” sipas të cilit parashikohet se: “2) *Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ*”.

Gjithsesi, pavarësisht faktit se kërkuesi nuk ka paraqitur prova të reja, për të mbështetur kërkesën për rishikim, Komisioneri vlerëson se edhe pretendimet e paraqitura në kërkesën e sipërcituar nuk qëndrojnë, për arsye të mëposhtme:

Në shkronjën c), të pikës 1, të nenit 2, të LDI parashikohet se: “*Autoritet Publik*” është “...c) *çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike*”.

Në analizë të dispozitës së sipërcituar, konstatohet se kërkuesi ka bërë një interpretim të gabuar të kësaj dispozite pasi, në rastin konkret nuk jemi para delegimit të ushtrimit të funksioneve publike por, kemi të bëjmë vetëm me delegim të ofrimit të shërbimit që këto subjekte tregtare kryejnë në përputhje me veprimtarinë e tyre private. Delegim ky i cili është i parashikuar edhe nga aktet përkatëse ligjore që rregullojnë këtë fushë.

Konkretisht, në pikat 3, 4 dhe 13 të nenit 2 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“...3. “*Funksion*” është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore.

4. “*Funksione të deleguara*” janë ato funksione të qeverisë qendrore, ushtrimi i të cilave u delegohet njësi të vetëqeverisjes vendore.

...

13. “*Shërbime publike*” janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative.

Në shkronjën “a” të pikës 1.6 të nenit 9, të drejtat e personit juridik parashikohet se: *Si persona juridikë, njësitë e vetëqeverisjes vendore gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë: a) të drejtën e lidhjes së kontratës.*

Ndërkohë, në nenin 14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Këshilli bashkiak, duke u mbështetur në nevojat e popullsisë për transportin qytetës, përcakton linjat, organizon, financon dhe vendos për këtë lloj transporti brenda juridiksionit të vet.... Transporti qytetës kryhet me autobus vetëm nga shoqëritë, të cilat kanë të shprehur në aktet e themelimit, si objekt të veprimtarisë,*

*veprimtarinë e transportit të udhëtarëve. Licenca për transportin qytetës jepet nga kryetari i bashkisë”.*

Në kuptim të këtyre dispozitave, bashkitë, brenda juridiksionit të tyre territorial, vendosin për kryerjen e këtij *shërbimi*, nëpërmjet operatorëve privatë.

Ndërkohë, në kontratën Tip, që Bashkia Tiranë lidh me shoqërinë e transportit të udhëtarëve ka përcaktuar qëllimin për *sigurimin e shërbimit të transportit qytetas të udhëtarëve brenda juridiksionit territorial të Bashkisë Tiranë nga ana e Operatorit për linjën “”, duke garantuar korrektësi, paanësi dhe transparencë gjatë kryerjes së shërbimit dhe kushte optimale shërbimi për udhëtarët. Pra, është Bashkia Tiranë, që nëpërmjet kontratës së lidhur përcakton kushtet për sigurimin e këtij shërbimi nga shoqëritë e transportit të udhëtarëve. Për rrjedhojë, shoqëritë e transportit të udhëtarëve kryejnë një shërbim publik të dhënë nëpërmjet kontratës së lidhur me bashkinë dhe jo një funksion të bashkisë, sipas argumentit të dhënë nga kërkuesi *se shoqëritë e transportit kryejnë funksion të bashkisë, ndaj janë autoritete publike.**

Në analizë të sa më sipër cituar, Komisioneri vlerëson se, bazuar në LDI, Autoritet Publik, në këtë rast konsiderohet Bashkia Tiranë, e cila duhet të disponojë të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm në funksion të kontratës së shërbimit, që ka lidhur me operatorin privat, referuar gjithashtu nenit 6 të Kontratës Tip, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë.

Nga ana tjetër, në asnjë dispozitë të kontratës Tip të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe operatorëve privat, nuk parashikohet detyrimi i këtyre të fundit për mbajtjen e informacionit të kërkuar dhe vendosjen në dispozicion të kërkuesve.

Përsa i përket pretendimit se, në nenin 16 të kontratës Tip, lidhur ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe Bashkisë Tiranë sipas të cilit: *“Operatori i linjës, me nënshkrimin e kësaj kontrate, është i detyruar të shqyrtojë ankesat - kërkesat e publikut lidhur me shërbimin, si dhe të informojë publikun mbi shërbimin në linjë, në zbatim të akteve të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore”,* operatorët ekonomik kanë detyrimin për të vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar, sqarojmë se qartësisht dispozita nuk i referohet informacionit/dokumentacionit që kërkohet sipas pikave të kërkesës për informacion. Për më tepër, referuar neneve 26, 27 dhe 28 të kontratës Tip, qartësisht është bashkia që garanton zbatimin e këtij detyrimi duke vendosur sanksion gjobë, në rastet kur informacioni në kontratë nuk jepet dhe jo Komisioneri.

Po ashtu, në nenin 17 të kontratës Tip parashikohet se: *“Operatori i Linjës, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, është i detyruar të informojë Drejtorinë e Transportit dhe Trafikut Rrugor: a) një herë në muaj për ecurinë e mbarëvajtjes së shërbimit të transportit publik qytetas në Linjë; b) një herë në muaj zërat ekonomikë të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas formatit të kërkuar; c) një herë në vit mbi xhiron vjetore, bilancin financiar, vlerën e investimeve dhe riinvestimeve të kryera dhe planifikimit financiar të investimeve që do të kryhet në të ardhmen”.* Referuar këtij parashikimi, operatori privat paraqet detyrimisht pranë Autoritetit Publik, Bashkia Tiranë informacion lidhur me zbatimin e kontratës, ku përfshihet gjithashtu informacioni lidhur me ecurinë e

mbarëvajtjes së shërbimit të transportit publik qytetës të Linjës. Ky rregullim shkon në të njëjtën linjë me arsyetimin e Komisionerit lidhur me autoritetin publik, përgjegjës për administrimin e informacionit të kërkuar.

Në vijim, lidhur me argumentin se: *Në praktikën e tij Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka konsideruar si autoritet publik, subjektin "ILLYRIAN GUARD" sh.a., shoqëri aksionere me kapital 100% private, përsa kohë ushtron funksion publik, Komisioneri vlerëson se ky argument nuk qëndron, pasi me vendimin nr. 177, datë 4.4.2019 të Këshillit të Ministrave është vendosur krijimi i shoqërisë tregtare "Illyrian Guard" sh.a., me kapital 100 % shtetëror, për ofrimin e shërbimeve ndaj personave fizikë e juridikë publikë dhe privatë.*

Një fakt i tillë provohet gjithashtu nga verifikimi i statusit juridik të subjektit "ILLYRIAN GUARD" sh.a., në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ku rezulton se është Shoqëri Aksionere me kapital 100 % shtetëror. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100 % të aksioneve të shoqërisë "Illyrian Guard" Sh.a., është Ministria e Brendshme.

Ndërkohë, për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, bazuar në ligjin nr. 10130, datë 11.05.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar, ku në nenin 2 të tij përcaktohet se: *"Fusha e veprimtarisë së FSHZH-së është nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit".*

Gjithashtu, në nenin 5 të ligjit të sipërcituar, në të cilin përcaktohet se: *"Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në këtë ligj, FSHZH-ja udhëhiqet nga këta objektiva kryesorë: a) përmirësimi i infrastrukturës social-ekonomike vendore; b) përmirësimi i shërbimeve publike vendore; c) forcimi institucional i njësisve të qeverisjes vendore; ç) nxitja e qeverisjes së mirë në nivel vendor".*

Në pikën 2 të nenit 6 të ligjit, janë përcaktuar kompetencat e FSHZH-së sipas së cilës: *"2. Kompetencat kryesore të FSHZH-së janë: a) menaxhimi i projekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare dhe/ose donatorë të ndryshëm, që kanë si qëllim zhvillimin rajonal dhe vendor. b) dhënia e mbështetjes financiare në të gjitha format, si grand, hua, garanci etj. për njësitë e pushtetit vendor, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore".*

Gjithashtu, në nenin 8 të tij, janë përcaktuar Burimet e financimit: *"1. Të ardhurat në buxhetin e FSHZH-së krijohen nga: a) fondet e përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe donatorëve të ndryshëm, për financimin e projekteve, të zbatuara nga FSHZH-ja; b) fondet nga Buxheti i Shtetit, nga individë dhe institucione, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve përkatëse; c) fondet nga bashkëfinancimi i përfituesve dhe i njësisve të qeverisjes vendore; ç) të ardhurat e përfituara nga aktivet e saj dhe shërbimet e ofruara; d) kontributet materiale nga programet dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe nga organizata të ndryshme jofitimprurese; dh) burime të tjera, të lejuara nga legjislacioni në fuqi. 2. Të ardhurat e krijuara FSHZH-ja i përdor për financimin veprimtarive të veta, sipas procedurave të përcaktuara në statut".*

Në analizë të këtyre dispozitave, Komisioneri vlerësoi se Fondi Shqiptar i Zhvillimit edhe pse në ligjin specifik të tij gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse, ai detyrohet t'i nënshtrohet LDI, për sa kohë menaxhon fonde publike dhe ushtron funksione publike. Ky qëndrim i Komisionerit është mbështetur gjithashtu dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në vendimin nr. 497, datë 24.02.2021.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike. E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Megjithatë, në lidhje me informacionin e kërkuar objekt i këtij shqyrtimi, Komisioneri vlerëson rëndësinë e tij për publikun, por nuk mund të dalë jashtë kornizës ligjore që përcakton kompetencat e tij, duke detyruar subjekte të cilat nuk janë Autoritet Publik në kuptim të LDI.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 146, të ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

### **V E N D O S A:**

1. Refuzimin e kërkesës nr. 1891 Prot., datë 01.11.2022, të Qendrës “ALTERUM” *“Për revokimin/shfuqizimin e vendimeve të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale”* dhe lënien në fuqi të akteve administrative, respektivisht, Vendimin nr. 31, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 32, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 33, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 34, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 35, datë 25.10.2022, Vendimin nr. 36, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 37, datë 25.10.2022; Vendimin nr. 38, datë 25.10.2022 dhe Vendimin nr. 39, datë 25.10.2022, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 02.12.2022.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**